

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar lidhur me njoftimin për përqendrim të parashtruar nga JASMIN SHPK Beograd (Palilula), me seli në rr. „Dunavska“ nr. 31, Palilula, Beograd, Republika e Serbisë, përmes Filip Videskit dhe Nikola Apostollovskit, avokatë nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 25.08.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin JASMIN SHPK Beograd (Palilula), me seli në rr. „Dunavska“ nr. 31, Palilula, Beograd, Republika e Serbisë, synon të fitojë kontroll mbi Shoqërinë për tregti dhe shërbime JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. „Metropolit Teodosij Golloganov“ nr. 72, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumën prej 6.000,00 denarë, si dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas Tarifës nr. 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Ligji), më 07.08.2026, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim nga JASMIN SHPK Beograd (Palilula), me seli në rr. „Dunavska“ nr. 31, Palilula, Beograd, Republika e Serbisë, me të cilin JASMIN SHPK synon të fitojë kontroll mbi Shoqërinë për tregti dhe shërbime JASMIN PARFIMERIJA SHPKEL Shkup, me seli në rr. „Metropolit Teodosij Golloganov“ nr. 72, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimi të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe shtojcave të tij, konstatoi sa vijon:

Veprimtaritë themelore afariste të ndërmarrjeve të prekura:

JASMIN SHPK Beograd ka si objekt veprimtarie tregtinë me pakicë të produkteve kozmetike dhe të tualetit në dyqane të specializuara, ndërsa ortak me shumicë në JASMIN SHPK Beograd, me pjesëmarrje prej 75%, është RADIKS SHPK Beograd (Palilula) nga Republika e Serbisë.

JASMIN SHPK Beograd dhe RADIKS SHPK Beograd nuk kanë prani të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizojnë të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Shoqëria për tregti dhe shërbime JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP ka si objekt veprimtarie tregtinë me shumicë dhe pakicë të preparateve të parfumerisë dhe kozmetikës. Ortaku i vetëm i JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP Shkup është Shoqëria për tregti dhe shërbime MATOSS GROUP SHPK Shkup, e cila ka lidhur një Marrëveshje paraprake për transferimin e tërësisë së pjesës së kapitalit të JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP Shkup te JASMIN SHPK Beograd, me realizimin e së cilës JASMIN SHPK Beograd do të fitojë kontroll të vetëm mbi JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP Shkup.

Pala tjetër në transaksion është Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë dhe shërbime TINEKS-MT SHPKNJP eksport-import Shkup, me seli në rr. „Vasil Gjorgov“ nr. 16-1/mansardë 1, Qendër, Shkup, e cila, nëpërmjet degëve të saj KOSMO Tinex Drogieri, që operojnë nën markën tregtare „Cosmo“, ushtron tregti me pakicë të preparateve të parfumerisë dhe kozmetikës, produkteve për higjienë personale, produkteve për higjienën e amvisërisë dhe produkteve të tjera të konsumit të gjerë.

JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP Shkup do të fitojë kontroll të vetëm mbi një pjesë funksionalisht të përcaktuar të ndërmarrjes së TINEKS-MT, përkatësisht JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP Shkup do të marrë përsipër operimin e katër njësive afariste – KOSMO Tinex Drogieri, të cilat si degë operojnë nën markën tregtare „Cosmo“ („Biznesi i synuar“), së bashku me stoqet e produkteve të gatshme, pajisjet dhe mobilet që ndodhen në to, ndërsa dyqanet e marra në përfundim do të vazhdojnë të operojnë nën një markë të re dhe të ndryshme. Pjesëmarrësit në përqendrim parashikojnë që, fillimisht, JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP Shkup të marrë përsipër operimin e katër njësive afariste – dyqaneve, dhe më pas e gjithë pjesa e kapitalit në JASMIN PARFIMERIJA SHPKNJP Shkup, në pronësi të MATOSS GROUP SHPK Shkup, t'i transferohet JASMIN SHPK Beograd. Të dyja veprimet juridike janë pjesë të kushtëzuara reciprokisht të një operacioni të vetëm.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i përmbush kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe të nenit 14 paragrafi (1), pikat 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1), pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, brenda 30 ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ